

OPERATORI I BLERJEVE TË PËRQËNDRUARA

FORMULARI I NJOFTIMIT TË FITUESIT (PARAPRAK)

Datë: 29.10.2024

Drejtuar: **LIGUS** sh.p.k

Adresa: Bulevardi Bajram Curri, Rruga Aleks Buda, Pallati I Jon 2002, Tirane

Procedura e prokurimit/lotit: E hapur, mbi kufirin e lartë monetar, Mallra

Numri i procedurës / referenca e Lotit: **REF-20716-09-19-2024**

Përshkrimi i shkurtër i kontratës: Loti 3 **“Blerje pajisje për Kabinetet Mekanike/Elektronike”**.

Fondi limit: 49.736.860 (dyzet e nëntë milion e shtatëqind e tridhjetë e gjashtë mijë e tetëqind e gjashtëdhjetë) lekë pa tvsh ose 501,127 (pesëqind e një mijë e njëqind e njëzet e shtatë) Euro pa TVSH.

Sipas Kursit të këmbimit të Bankës së Shqiperisë më datë 19.09.2024 është 99.25.

Kohëzgjatja e kontratës: Loti 3 “Blerje pajisje për Kabinetet Mekanike/Elektronike” me afat lëvrimi 4 (katër) muaj nga lidhja e kontrates.

Publikimet e mëparshme: Buletini i Njoftimeve Publike Nr. 63 datë 23.09 2024

Kriteret e përzgjedhjes së fituesit:

oferta ekonomikisht më e favorshme bazuar në kosto

oferta ekonomikisht më e favorshme bazuar në çmim

Me anë të këtij Njoftimi ju informojmë se, në këtë procedurë kanë marrë pjesë Ofertuesit e mëposhtëm me këto vlera përkatëse të ofruara:

1. Operatori ekonomik “DIVITECH” sh.p.k NUIS L013060490

Vlera: 48,086,800 (dyzet e tetë milion e tetëdhjetë e gjashtë mijë e tetëqind) lekë pa TVSH;

2. Operatori ekonomik “LIGUS” sh.p.k NUIS L51523001S

Vlera: 46,290,500 (dyzet e gjashtë milion e dyqind e nëntëdhjetë mijë e pesëqind) lekë pa TVSH.

Nga pjesëmarrësit janë skualifikuar Ofertuesit e mëposhtëm:

1 Operatori ekonomik “DIVITECH” sh.p.k NUIS L013060490

arsyet e mëposhtme

Operatori ekonomik nuk plotëson pikën:

2.3.1 të “Kapacitetit teknik” pasi OE nuk ka paraqitur dokumentacion provues ose dëshmi për realizimin me sukses të një ose disa kontratave të mëparshme të ngjashme, të kryera gjatë tre viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, në një vlerë jo më të vogël se 40% të vlerës së përlogaritur të fondit limit.

2.3.2 të “Kapacitetit teknik” pasi OE nuk ka paraqitur Autorizim/Marrëveshje me prodhuesin/distributorin e autorizuar nga prodhuesi për mallrat objekt prokurimi. Në rast të paraqitjes së autorizimit nga distributori i autorizuar nga prodhuesi duhet të provohet lidhja ndërmjet prodhuesit dhe distributorit zyrtar të autorizuar nga prodhuesi. Autorizimi duhet të përmbajë të dhëna të plota të prodhuesit si: (*telefon, fax, e-mail, website*) të nevojshme për autoritetin kontraktor në rast verifikimi nga ana e tij.

2.3.3 të “Kapacitetit teknik” pasi OE nuk ka paraqitur katalog / skedën teknike për të gjitha mallrat objekt prokurimi për të cilat oferton ku të tregohen dhe të markohen qartë karakteristikat e mallit/mallrave që do të ofrohen, në mënyrë që të krahasohet pajtueshmeria e tyre me specifikimet teknike dhe standartet e kërkuara në dokumentat standarte të tenderit.

2.3.4 të “Kapacitetit teknik” pasi OE nuk ka paraqitur ofertën teknike për artikujt objekt prokurimi.

2.3.5 të “Kapacitetit teknik” pasi OE nuk ka paraqitur deklaratë me anë të së cilës merr përsipër të kryejë shërbimin e transportit, shpërndarjen dhe montimin e të gjithë mallrave në adresat e përcaktuara.

2.3.6 të “Kapacitetit teknik” pasi OE nuk ka paraqitur deklaratë garancie për mallrat objekt prokurimi për një periudhë minimale prej 1 (një) viti nga data e dorëzimit të tyre.

2.3.7 të “Kapacitetit teknik” pasi OE nuk ka paraqitur Çertifikatën ISO 9001:2015 “Mbi sistemet e menaxhimit të cilësisë” (e vlefshme) ose ekuivalent, të lëshuara nga organizmat e vlerësimit të konformitetit, të akredituara nga organizmi kombëtar akreditues, ose organizma ndërkombëtare akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë, në përputhje me objektin e prokurimit.

* * *

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur, informojmë Operatorin ekonomik “LIGUS” sh.p.k, me adresë: Bulevardi Bajram Curri, Rruga Aleks Buda, Pallati I Jon 2002, Tiranë, se oferta e paraqitur me vlerë totale prej 46,290,500 (*dyzet e gjashtë milion e dyqind e nëntëdhjetë mijë e pesëqind*) lekë pa TVSH / totali i pikëve të marra [_____] është identifikuar si fitues (paraparak) i procedurës së prokurimit.

Me publikimin e këtij njoftimi, fillojnë afatet e ankimit sipas përcaktimeve në nenin 110 të Ligjit Nr.162/2020, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik”.